



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIĆ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izlazna

Nr. -1- 71
Br.

Data 31.05.2023
Datum

OBILIQ-OBILIĆ



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIĆ

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ

Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), nenit 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës nr.-I-34, të dt.25.04.2016, si dhe nenit 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, sipas Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.-03/2020 për Transparencë në Komunë, Kuvendi komunal pas shqyrtimit të kërkesës nga DAP-ja, nr.-III-139, të dt.23.05.2023, në mbledhjen e mbajtur me dt. 31.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Plani i Veprimit për Transparencë 2023-2027.

2. Ky Vendim hyn në fuqi (15) pesëmbëdhjetë ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të MAPL-së, dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .

T'i dërgohet

- Kryetarit
- Nënkryetarit
- Kryesueses
- Anëtarëve të KK
- DAP
- MAPL
- Arkivit



Kryesuese e Kuvendit Komunal

Vlora-Mjekiqi Kabashi



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIĆ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-izlazna

Nr. -1-71
Br. _____

Data 31.05.2023
Datum _____

OBILIQ-OBILIĆ



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



Kuvendi Komunal Obiliq
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

PLANI I VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË 2023-2027

Deklarata e transparencës

Kjo deklaratë ka për qëllim ofrimin e një pikëpamje gjithëpërfshirëse që pasqyron qartazi politikat, procedurat dhe masat tona operative përkitazi me transparencën, gjithëpërfshirjen, kulturën organizative dhe llogaridhënien. Deklarata mbështetet në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Strategjinë Vetëqeverisje Lokale dhe aktet tjera komunale rregullative.

Plani i Veprimit për transparencë synon të kontribuojë në ndërtimin e një administrate komunale llogaridhënëse dhe transparente, të hapur për qytetarë dhe shoqërinë civile në të gjitha proceset vendimmarrëse. Përmes Planit, do të promovohet koncepti i demokracisë së drejtpërdrejtë lokale, në mënyrë që politikbërja të bazohet në argumente, fakte dhe të dhëna reale. Plani është dokument strategjik komunal, i hartuar në pajtim me orientimet e përcaktuara nga Strategjinë për Vetëqeverisje lokale dhe aktet juridike përcjellëse të nivelit qendror që promovojnë qeverisjen transparente.

Llogaridhënia dhe transparenca janë parime që përtej informimit, synojnë mekanizma të përfshirjes së qytetarëve në procesin e politikbërjes dhe vendimmarrjes komunale. Për këtë arsye, zotohemi që Komuna e Obiliqit me gjithë sinqeritetin dhe përkushtimin do të rris gatishmërinë, për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive të gjitha kërkesave të qytetarëve për të qenë të angazhuar aktivisht në planifikimin dhe zhvillimin e politikave, për të siguruar që efektet e zbatimit të tyre të japin rezultatet e dëshiruara dhe afektojnë direkt interesin e përgjithshëm të qytetarëve.

Me plan të transparencës, ne do të zbatojmë në mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse standardet, parimet, objektivat, metodat dhe mjetet efektive për rritjen e llogaridhënies, inkurajimin e qytetarëve për t'u bërë pjesë e qeverisjes, si dhe të ndikojmë tek punonjësit për të promovuar sjellje të mirë dhe të përgjegjshme.

Ne vlerësojmë se planifikimi i bazuar në informacion është metoda më e mirë e ndërtimit të qëndrueshëm të vizionit zhvillimor. Në funksion të kësaj, shërbimet cilësore komunale dhe administrimi i kërkesave të qytetarëve varet drejtpërdrejtë nga mënyra e shpërndarjes së informatave, sistemet e aplikuara të informacionit, teknikat e konsultimit dhe veprime të tjera përcjellëse të organeve të administratës.

Prandaj, jemi të përkushtuar që jo vetëm të zbatojmë masat e ndërlydhura me informim, por të bëjmë përpjekje për të siguruar praninë e vazhdueshme të qytetarëve dhe grupeve të interesit, me theks të veçantë organizatave të shoqërisë civile, duke përvijuar konceptin qytetarisë aktive dhe ndërtimit të qeverisjes së opinionit publik.

Besojmë që ky plan veprimit për transparencë do të jetë një ndihmesë në rritjen e efikasitetit të shërbimeve, në krijimin e një ambienti më transparent të punës në administratë, rritjen e besimit të qytetarëve ndaj të zgjedhurve të tyre publike, gatishmërisë dhe përkushtimit më të madh, si dhe përpjekjeve për të fuqizuar e përmirësuar sistemin e menaxhimit brenda komunal.

Maj, 2023

Kryesuesja e Kuvendit Komunal
Vlora Mjekiqi Kabashi



Hyrje

Transparenca dhe llogaridhënia janë elementet thelbësore të qeverisjes së mirë në nivelin lokal. Rruga drejt informimit publik efikas duhet të jetë baza e qeverisjes së mirë, ndërkaq, komunikimi efektiv me qytetarët dhe pjesëmarrja e tyre në zhvillimin dhe zbatimin e politikave të komunës është aspekti kyç që siguron vendimmarrje me bazë të gjerë. Fryma e institucioneve komunale duhet të adoptoj modelet më të avancuara të qeverisjes transparente brenda kornizës ligjore në fuqi .

Transparenca komunale është njëra nga segmentet e qeverisjes e cila monitorohet në vazhdimësi nga qeveria qendrore, por edhe nga akterë të tjerë ndërkombëtar, Komisioni Evropian, organizatat ndërkombëtare, si dhe organizatat joqeveritare. Marrë parasysh nivelin e përgjegjësive dhe shkallën e decentralizimit të pushtetit lokal në Kosovë, Kushtetuta dhe legjislacioni kanë paraparë të drejtën e autoriteteve qendrore për të ofruar mbështetje dhe mbikëqyrje në faza të caktuara të procesit të avancimit të transparencës dhe zhvillimit të politikave për përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje lokale.

Komunat si njësi themelore të vetëqeverisjes lokale janë të obliguara t'i krijojnë mekanizmat e përshtatshëm të informimit publik. Tani, struktura e ueb-faqeve zyrtare të komunave është unike. Përmes tyre është krijuar mundësia për qasje në të gjitha dokumentet me rëndësi publike. Përveç karakterit informues, ato mundësojnë edhe procese administrative dhe linja me ndërfaqe të tjera të cilat shërbejnë për procesin e konsultimit publik. Ndërlidhja e tyre me sistemin e intranetit në komunë, mundëson që qytetarët të parashtrojnë online të gjitha kërkesat e tyre ndaj drejtorive përkatëse në komunë.

Fusha e transparencës komunale ka një strukturë të mirëorganizuar të rregullave juridike ligjore dhe nënligjore. Plani i Veprimit për Transparencë synon t'i grupoj përgjegjësitë kryesore të komunave bazuar në këtë rregullativë juridike, për të shërbyer si dokument kornizë në një periudhë afatgjatë.

PLANI I VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË

Plani i veprimit për transparencë komunale ka për qëllim t'i ofrojnë publikut qasje të lehtë në mbikëqyrjen dhe zbatimin e politikave nga organet e komunës, duke përfshirë informim të shpejtë, të dhëna të qasshme, publikimin e të gjitha akteve normative dhe dokumenteve me interes publik, si dhe rritje të mundësive të pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

Udhëzimi Administrativ Nr.2020/03 për Transparencë në Komuna përcakton obligimin që Komunitat të hartojnë planin katër (4) vjeçar të veprimit për transparencë. Ky plan, kërkon nga komuna të ndërmarrë veprime konkrete në promovimin dhe ofrimin e transparencës së plotë tek: mbledhjet e Kuvendit të Komunës, mbledhjet e komiteteve, takimet publike, takimet konsultative për projektakte, transparencën në planifikimin dhe shpenzimin e buxhetit të komunës, qasje të shpejtë në shërbime elektronike (me sa më pak klikime) dhe fizike, procedura transparente në aktivitetet e prokurimit, procedura transparente të punësimit, përditësimin e vazhdueshëm të aktiviteteve ditore në faqe zyrtare të komunës, përfshirjen aktive të qytetarëve në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe akteve tjera që i konsideron komuna të domosdoshme për konsultim.

Plani i Veprimit për Transparencë mundëson:

- Prezantimi i planifikimit të punëve të organeve të vetëqeverisjes lokale me sistemet e informacionit në mënyrë që puna e organeve të administratës gjatë zhvillimit të politikave të vërtetohen dhe legjitimohen;
- Përfshirjen e qytetarëve dhe shoqërisë civile në mënyrë aktive dhe të vazhdueshme në hartimin dhe zbatimin e politikave në nivel lokal;
- Rezultatet e punës së komunave të jenë të matshme, cilësore dhe në funksion të interesave të përgjithshme të qytetarëve.

Plani i veprimit për transparencë në mënyrë specifike do të kontribuojë që:

- Komuna të identifikojë me kohë prioritetet për të cilat kërkohet informimi, si dhe përfshirja e qytetareve apo grupeve të interesit në proces të hartimit të politikave dhe akteve të përgjithshme;
- Të identifikojë metodat, mjetet dhe teknikat për konsultimin e qytetarëve dhe përfshirjen e tyre në procese;

- T'i evitoj praktikat e zhvillimit të dokumenteve dhe politikave pa respektim të procedurave ligjore lidhur me informimin dhe konsultimin e qytetarëve si dhe të evitoj praktikat e zhvillimit të dokumenteve dhe politikave me kosto të papërballueshme;
- Krijimin e një mjedisi të brendshëm transparent dhe llogaridhënës, duke inkurajuar bashkëpërgjegjësi të të gjithë stafit në procesin e zhvillimit, zbatimit dhe mbikëqyrjen e politikave;
- Mbajtjen e një sistemi dhe përditësim i vazhdueshëm me të dhënat e të gjitha palëve të interesit për të siguruar pjesëmarrjen e qytetarëve në pajtueshmëri me kërkesat dhe standardet ligjore;
- Ndikimin në sjelljet e punonjësve komunal në mënyrë që veprimet e ndërmarra të demonstrojnë ligjshmëri dhe integritet;

Zbatimi i Planit të veprimit për transparencë do të monitorohet në vazhdimësi me mekanizma përkatës dhe do të rishikohet periodikisht në përputhje me aktivitetet e komunës. Plani do të përmbledh në mënyrë të qartë transparencën e organeve komunale, publikimin e akteve nënligjore, rregulloret komunale, dokumentet strategjike, vendimet e kryetarit, njoftimet për aktivitetet e komunës (ekzekutivit dhe kuvendit të komunës), takimet publike, planifikimin dhe shpenzimet buxhetore të komunës, prokurimin publik, zbatimin e standardeve të konsultimit publik, qasjen në dokumentet publike etj.

Transparenca si parim i qeverisjes së mirë

Në një sistem demokratik funksional, informimi dhe përfshirja duhet të jenë segment vital i administrimit publik. Transparenca është komponentë kryesore e qeverisjes demokratike, e cila kërkon një hallkë të gjerë të veprimeve institucionale, si në procesin e hartimit të politikave ashtu edhe në fazën e zbatimit dhe raportimit. Rëndësia e transparencës ndikon në aspekte të shumta duke përfshirë qëndrueshmërinë ekonomike, financiare, qeverisjen e mirë, si dhe në sistemin e përgjithshëm të administratës shtetërore. Parimi i publicitetit dhe transparencës supozojnë se çdo kush ka të drejtë të dijë arsyet e nxjerrjes së një vendimi të caktuar apo veprimi të administratës. Përmes këtij parimi mundësohet hapja e administratës para shoqërisë, informimi për punën e saj mund të bëhet në mënyrë të ndryshme dhe në vëllim të ndryshëm, parim që mund të kufizohet vetëm në rastet e caktuara në legjislacionin e secilit vend. Të qenurit i hapur dhe transparent janë gjithashtu instrumente të nevojshme për shtetin e së drejtës, barazinë para ligjit, dhe përgjegjshmërinë. Si rregull i përgjithshëm, sjellja e administratës publike duhet të jetë transparente dhe e hapur, megjithëse të dhënat personale nuk duhet t'i lejohen palëve të treta.

Transparenca është një nga çështjet më me peshë në procesin e demokratizimit të shteteve dhe qeverisjes së mirë. Këtë e mundësojnë mekanizmat dhe iniciativat e qeverisjes së hapur, të cilat bëjnë që përfitimet e transparencës të jenë në shumë aspekte, përfshirë: qeverisje më e mirë, vendimmarrje më cilësore, besim më të madh publik, ulje të korrupsionit dhe shërbime publike më efektive. Transparenca përfshin rregullat mbi të drejtat e krijimit, ruajtjes, qasjes dhe përpunimit të informacionit, të cilat mund të shfrytëzohen gjatë proceseve të vendimmarrjes, por edhe për nevoja të informimit të përgjithshëm. Për më tepër, në kuptim më të gjerë transparenca nuk është vetëm informim, por përfshinë një varg procesesh dhe veprimesh të bazuara në: informacion, komunikim, pjesëmarrje, angazhim, ndërtim të konsensusit për zgjidhjen e problemeve, raportim dhe llogaridhënie.

Korniza ligjore për transparencë

Në pajtueshmëri me Kushtetutën e Kosovës janë miratuar një numër i madh i ligjeve dhe akteve nënligjore, që rregullojnë fushën e transparencës. Ligji për Vetëqeverisje Lokale është aprovuar në vitin 2008 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe bën pjesë në grupin e ligjeve me karakter vital për shtetin. Përmbajtja e këtij ligji reflekton parimet e Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, duke paraparë mekanizma të veçantë të informimit, pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të të drejtave të qytetarëve, e në veçanti të drejtave të komuniteteve joshumicë. Me këtë ligj është përcaktuar që kuvendi i komunës të miratojë rregulloren komunale që promovon transparencë të organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative të komunës, duke e rritur pjesëmarrjen e opinionit në marrjen e vendimeve në nivel lokal dhe duke lehtësuar qasjen publike në dokumentet zyrtare të komunë. Përveç kësaj, me anë të një numri të konsiderueshëm të akteve nënligjore janë definuar edhe procedurat e zbatimit të instituteve të shumta juridike për transparencë, janë përcaktuar zyrtarët përgjegjës, format dhe teknikat për transparencë, si dhe afatet procedurale. Në përgjithësi, kuadri juridik normon obligime për organet e administratës shtetërore në fushën e transparencës, ndërsa në veçanti për organet e pushtetit, përmes akteve si në vijim:

- Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale;
- Ligji Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike;
- Ligji Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Ligji Nr. 03/L-178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë;
- Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative;
- Ligji Nr.04/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 03/L-211;
- Ligji Nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve;
- Ligji Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës

- Rregullore (QRK) Nr. 27/2018 për Shërbimin e Komunikimit Qeveritar me Publikun;
 - Rregullore Nr.04./2012 për Evidencën Zyrtare të Kërkesave për Qasje në Dokumente Publike;
 - Rregullore (QRK) Nr. 05/2016 për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik;
 - Rregullore Nr. 02/2012/MF për Tarifat në qasje në dokumente publike;
-
- Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.03/2020 për Transparencën në Komuna;
 - Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna;
 - Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 01/2019 për Monitorimin e Kuvendeve të Komunave Përmes Pajisjeve të Teknologjisë Informative “Teleprezencave”;
 - Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.01/2021 për Funksionimin e Qendrave të Shërbimeve të Qytetarëve në Komunë;
 - Udhëzim Administrativ Nr.01/2015 për Ueb-faqet e Institucioneve Publike
 - Rregullore (MAPL) Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës;
 - Rregullore Nr.01/2020 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Skemën e Grantit të Performancës Komunale;
 - Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna;

Aktet komunale:

- Statuti i komunës;
- Rregullore komunale për transparencë;
- Rregullore komunale për përdorimin e gjuhëve;
- Akte të tjera ligjore dhe nënligjore që ndërlidhen me fushën e transparencës.

Qasja strategjike për fuqizimin e transparencës

Në nivel qendror janë zhvilluar një numër strategjish të cilat parashohin objektiva me synim reformën e administratës shtetërore. Ndër strategjitë kryesore në fushën e qeverisjes së mirë, transparencës, llogaridhënies dhe integritetit në institucionet e administratës janë:

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim, 2016-2021;
- Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026;
- Strategjia për Rregullim më të Mire 2017-2021;
- Strategjia për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave 2017-2021;

- Strategjia për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023;
- Agjenda për Reforma Evropiane;
- Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKMSA)
- Strategjitë e tjera sektoriale.

Dokument specifik me ndikim në transparencën komunale është Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026. Kjo strategji ka 5 objektiva kryesore përmes së cilave përcaktohen caqet afatmesme dhe afatgjata të zhvillimit të pushtetit lokal në Kosovë. Në objektin e tretë të saj, strategjia parasheh *forcimin e partneriteteve ndërmjet pushtetit lokal, shoqërisë civile dhe bizneseve për të krijuar një qytetari aktive, gjithëpërfshirëse dhe kohezive*. Bazuar në problemet e identifikuar, në planin e veprimit të kësaj strategjie parashihen aktivitetet konkrete të masave, që përfshijnë zhvillimin e politikave efektive për të nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve, respektivisht:

- Politikat lokale për nxitjen e aktivizimit qytetar;
- Politikat për nxitjen e punës vullnetare të studentëve dhe nxënësve;
- Politikat për funksionalizimin e qendrave rinore nëpër fshatra;
- Politikat për funksionalizimin e këshillave të fshatrave;
- Politikat për përfshirjen dhe angazhimin e pensionistëve në jetën publike;
- Politikat për angazhimin e personave me aftësi të kufizuara;
- Politikat për nxitjen e pjesëmarrjes së grave si dhe kategorive sociale të pambrojtura;
- Politikat lokale për trajtimin e fëmijëve të rrugës;
- Politikat lokale për krijimin e rrjeteve sociale, ekonomike, rinore, sportive dhe kulturore.¹

Strategjia parasheh po ashtu masa konkrete në krijimin e platformave që fuqizojnë transparencën, e në veçanti përmes qeverisjes elektronike. Qeveria elektronike sigurisht që lehtëson komunikimin në mes të grupeve të interesit me autoritetet publike, derisa ajo forcon administratën përmes: kursimit të kohës në ofrimin e shërbimeve, uljes së kostos operative, rritjes së efikasitetit, ruajtjes së memories institucionale dhe rritjes së llogaridhënies.

Komisioni Evropian ndër vite përmes raporteve të progresit ka identifikuar mangësi në fushën e transparencës duke renditur problemet kryesore, por në disa raste edhe të arritura. Referuar në të gjeturat e raportit të KE-së për vendin në vitin 2018, dobësitë vërehen në:

- Miratimin e projektligjeve nga Kuvendi i Kosovës pa një konsultim me grupet e synuara për shkak të procedurave të përshpejtuara;
- Shkallë e dobët e kalimit të dokumenteve në diskutim publik (vetëm 21% të dokumenteve i janë nënshtruar konsultimit publik);
- Shkallë e ulët reagimit të shoqërisë civile dhe përfshirjes së publikut në vendimmarrje;
- Progres është evidentuar në hyrjen në fuqi të dy rregulloreve: Rregullores për standardet e konsultimit dhe Rregullores për financimin e OJQ-ve”.

¹Qeveria e Republikës së Kosovës: “Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026”, Prishtinë, 2016, fq. 32

Andaj, masat e tilla të ndërhyrjes janë të rëndësishme, për faktin se përmirësojnë komunikimin me qytetarë, krijojnë hapësirë për politikbërje të qëndrueshme, zbatim efikas të tyre, si dhe plotësojnë obligimet e Kosovës në raport me kriteret e kërkuara nga Bashkimi Evropian

Mekanizmat ligjorë për pjesëmarrje dhe zbatim të parimit të transparencës

Qeverisja lokale në Kosovë promovon fuqishëm parimet e transparencës, llogaridhënies dhe përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje. Mënyra e parë dhe më e thjeshtë në të cilën transparenca mund të ndihmojë në ofrimin e paanësisë është duke lejuar publikun të luajë një rol të rëndësishëm në garantimin që rregullat të zbatohen në mënyrë të drejtë dhe korrekte. Qytetarët nuk mund të jenë askund më afër me shtetin se përmes organeve të pushtetit lokal. Komunitat janë adresa më e afërt për të kërkuar që shërbimet dhe resurset shpërndahen në mënyrë të drejtë, të barabartë dhe në pajtim me nevojat sistematike të tyre.

Numri më i madh i taksave dhe tatimeve që mbledhen nga shteti, u shpërndahen komunave për ushtrimin e kompetencave ligjore. Taksat për të cilat qytetarët paguajnë në baza periodike janë burime vetanake të komunave, të cilat shpenzohen për shërbimet e ofruara. Planifikimi i shpenzimit të tyre bëhet me anë të buxhetit komunal, që është dokument kryesor vjetor që mbledh të gjitha projektet investive me interes publik. Gjatë përgatitjes së buxhetit, komunitat ligjërisht obligohen të mbajnë konsultime me qytetarët, bizneset, grupet e interesit dhe shoqërinë civile. Prandaj, qeverisja e mirë komunale do të zinte vend vetëm nëse planifikimi i mjeteve buxhetore, politikave të tjera, shpenzimet e tyre dhe mënyra e shpërndarjes së investimeve publike do të mbështetej në opinionin e qytetarëve, përmes formave të shumta të përfshirjes direkte të tyre.

Në mënyrë që transparenca të jetë pjesë përbërëse e politik bërjes në nivel lokal, Ligji për Vetëqeverisje Lokale ka përcaktuar një numër të shumtë të instrumenteve juridike për pjesëmarrje të qytetarëve në jetën publike ku bëjnë pjesë:

- Takimet publike gjithëpërfshirëse me qytetarë;
- Konsultimet për projekt-aktet dhe dokumente të politikave;
- Informimi dhe konsultimi përmes e-qeverisjes;
- Bashkëpunimi me shoqërinë civile;
- E drejta për qasje në dokumentet publike.
- Komitetet konsultative;
- Iniciativat qytetare, petitionet dhe referendumet lokale;

Të gjitha këto forma kanë bazën e tyre juridike, procedurale, mjetet dhe format e zbatimit të tyre. Efekti i tyre në përmirësimin e qeverisjes lokale vërehet përmes rritjes së transparencës, krijimit të qytetarisë aktive dhe forcimit të dialogut social. Edhe pse të shumta, aplikimi i tyre ndryshon nga njëra komunë në tjetrën, për çka tregojnë statistikatat e shumta të dala nga raportet e

monitorimit të institucioneve të ndryshme publike dhe jopublike. Gjithashtu, jo të gjitha janë të zbatueshme për shkaqe juridike, por edhe praktike.

Objektivat e Planit të Veprimit për transparencë

Objektivi kryesor i Planit të Veprimit për Transparencë Komunale është *“të siguroj qeverisje të hapur për qytetarë, gjithëpërfshirje në procesin e planifikimit dhe zhvillimit të politikave, si dhe qeverisje transparente dhe llogaridhënëse”*.

Objektivat specifike janë:

- Sigurimi i një kornize të qartë të planifikimit të organizuar, ku përcaktohen rolet e të gjithë pjesëmarrësve përgjegjës për transparencë komunale.
- Fuqizimi i mekanizmave lokal të demokracisë direkte, për të krijuar një publik të interesuar për çështje publike;
- Avancimi i mekanizmave të informimit në mënyrë që qytetarët të dëgjohen dhe të inkurajohen për të qenë aktiv në proceset vendimmarrëse.
- Krijimi i një sistemi efektiv qeverisës, në të cilin parim kryesor i draftimit të politikave është baza e informacionit.
- Ndërtimi i partneritetit të mirëfilltë me shoqërinë civile, në të gjitha fazat e menaxhimit të organeve komunale.

Fazat e zhvillimit të Planit të Veprimit për Transparencë Komunale

Zhvillimi i Planit të Veprimit për Transparencë duhet të kalojë në disa faza si në vijim:

- 1) **Faza Paraprake** – Kryetari i komunës themelon grupin e punues. Përbërja e grupit punues duhet të jetë shumësektoriale dhe të udhëhiqet nga Zyra për Komunikim Publik në bashkëpunim me zyrën ligjore të komunës. Procedurat e hartimit zhvillohen në pajtim me rregullat në fuqi për procedurat e hartimit të akteve komunale.
- 2) **Faza e vlerësimit të prioritetëve** – gjatë kësaj faze, kryesuesi së bashku me grupin punues analizon dokumentacionet e mbledhura (legjislacionin dhe aktet nënligjore të zbatueshme në punën e administratës së komunës; dokumentet strategjike të komunës mbi bazën e të cilave priten të zhvillohen aktet juridike të komunës, planet komunale, dokumentet e tjera të politikave për të cilat duhet të zhvillohen konsultime publike dhe të sigurohet prania e qytetarëve. Mbi bazën e analizës së gjendjes aktuale dhe planeve afatshkurtëra, afatmesme dhe afatgjate, duhet të përcaktohen prioritetet dhe të bëhet renditja e veprimeve për secilin aktivitet.
- 3) **Faza e përcaktimit të aktiviteteve dhe propozimit të masave** – kjo fazë përfshin kategorizimin e prioritetëve sipas periudhave të zhvillimit, renditjen e aktiviteteve,

metodave dhe mjeteve të veprimit, afatet kohore, organet/zyrtarët përgjegjës, koston financiare.

- 4) ***Faza e mbikëqyrjes dhe raportimit të planit të veprimit për transparencë*** -përfshin mbikëqyrjen, regjistrimin dhe raportimin e rregullt të aktiviteteve që zhvillohen sipas Planit të veprimit për transparencë. Raportimi mundëson që informacionet e mbledhura të përdoren në marrjen e vendimeve që përmirësojnë zbatimin e objektivave të Planit të Transparencës Kryesuesi i grupit Punues merr pjesë në grupin punues për hartimin e planit vjetor të punës së komunës.

Metodologjia e vlerësimit dhe përcaktimit të aktiviteteve të transparencës

Vlerësimi i aktiviteteve të transparencës do të thotë renditja e veprimeve në Plan sipas prioriteteve, duke mundësuar që komuna të jetë e hapur dhe bashkëpunuese me qytetarë në të tri fazat kyçe të menaxhimit:1) Planifikim; 2) Zbatim; 3) Raportim.

Prioritetet përcaktohen duke marrë për bazë rëndësinë e proceseve, përkatësisht: natyrës së veprimtarisë që do të ndërmerret nga organi përkatës i komunës, llojeve të dokumenteve të politikave për të cilat kërkohet përfshirja e qytetarëve, fushëveprimit të akteve juridike të planifikuara për hartim, ndikimit të tyre ekonomik dhe social, peshës financiare të politikës së propozuar, periudhës kohore të veprimit, shtrirjes gjeografike, etj.

Pas përcaktimit të aktiviteteve grupi punues cakton prioritetet dhe metodat e veprimit të cilat duhet të jenë pjesë përbërëse e planit të veprimit, të cilat janë të ndryshme varësisht se për cilën fazë të menaxhimit bëhet fjalë.

Mbikëqyrja e zbatimit të Planit të Veprimit për Transparencë

Zbatimi i Planit të Veprimit për Transparencë do të mbikëqyret në vazhdimësi me mekanizma përkatës, do të rishikohet periodikisht dhe do të azhurnohet në përputhje me ndryshimet ligjore , institucionale, procedurale dhe të personelit, në varësi të ndikimeve nga mjedisi i jashtëm apo i brendshëm i Komunës.

Mbikëqyrja e vazhdueshme në zbatim është e rëndësishme për t'u siguruar se masat e parapara janë efektive dhe ndikojnë në cilësinë e politik-bërjes, si parakusht i ligjshmërisë së procesit vendimmarrës. Gjithashtu, mbikëqyrja duhet të përcaktojë nëse masat e përdorura kanë prodhuar efektet e planifikuara, kanë sjellë vendimmarrje cilësore, efikase dhe efektive, me kosto reale dhe të përballueshme.

Raportimi i rregullt siguron se zbatimi i Planit bëhet në përputhje me orarin dhe se rezultatet e planifikuara janë arritur. Me qëllimi të sigurimit të zbatimit të Planit të Veprimit për Transparencë, krijohet mekanizmi për mbikëqyrje dhe raportimin e këtij plani, si në vijim:

Grupi punues -emërohet me vendim të kryetarit të komunës dhe është përgjegjës për:

- Hartimin e Planit të Veprimit për Transparencë Komunale;
- Grupi është njëherësh sigurues i zbatimit të Planit dhe garanton që në baza periodike Plani Vjetor i Punës së Komunës të ndërlidhet me aktivitetet dhe masat e përcaktuara në Planin Vjetor të Veprimit për Transparencë;
- Kryesuesi i grupit Punues merr pjesë në grupin punues për hartimin e Planit Vjetor të Punës së komunës.
- Propozon masa të nevojshme për zbatimin e plotë të masave të propozuara në Planin e Veprimit për Transparencë;
- Mbikëqyrë zbatimin e masave për përmirësimin e transparencës;
- Raporton tek kryetari për zbatimin e Planit të Veprimit për Transparencë;

Plani i Veprimtimit për Transparencë Komunale

Objektivat	Aktivitetet	Treguesit e matjes	Afati kohor	Njësia/personi përgjegjës	Mënyra e njoftimit/zbatimit	Dokumentet referuese	Kolonë raportimi
Transparenca e kuvendëve të komunave							
Informimi i rregullt i qytetarëve dhe grupeve të interesit për aktivitetet dhe vendimet e Kuvendit të komunës dhe komiteteve	Publikimi i njoftimeve, sigurimi i materialeve të nevojshme, hapësirës për pjesëmarrjen publikut dhe përfaqësuesit e mediave të shkruara/elektronike në takimet e Kuvendit të komunës dhe komiteteve	1) Numri i njoftimeve të shpallura në gjuhët zyrtare për mbledhje të kuvendit në ueb faqe zyrtare të komunës ; 2) Numri i njoftimeve të shpallura në gjuhët zyrtare për mbledhje të komiteteve në ueb faqe zyrtare të komunës.	1) Njoftimi shtatë (7) ditë pune para mbledhjeve të rregullta Kuvendit; 2) Njoftimi 3 ditë pune para mbledhjes së jashtëzakonshme; 3) Thirrja brenda ditës për mbledhje urgjente.	Kryesuesi i kuvendit të Komunës; Kryesuesi i Komitetit përkatës; Sekretaria e Kuvendit; Zyra për informim.	Përmes ueb-faqes zyrtare; Shpalljeve publike; Formave të tjera të informimit.	- Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; - Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna; - Statuti i Komunës; - Rregullorja komunale për transparencë.	
	Transmetimi në kohë reale i mbledhjeve të kuvendit të komunës	Numri i mbledhjeve të kuvendit të transmetuara drejtpërdrejtë	Në vazhdimësi	Sekretaria e kuvendit; Zyrtari i IT-së; Zyra e informimit.	Përmes ueb-faqes zyrtare; Rrjetete sociale; Youtube; Mediave lokale.	- Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; - Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;	

	Publikimi i raportit të punës së kuvendit të komunës	Raporti vjetor i publikuar në gjuhët zyrtare	Deri më 31 janar për vitin paraprak	Kryesuesi i kuvendit; Sekretaria e Kuvendit Zyra për informim;	Ueb-faqja e komunës; Platforma të tjera sociale.	Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna Rregullorja komunale për përdorimin e gjuhëve.	
	Publikimi i profileve të anëtarëve të kuvendeve të komunave	Biografite e anëtarëve të kuvendit dhe të dhënat kontaktuese të publikuara;	Me rastin e marrjes së mandatit;	Kryesuesi i kuvendit të komunës; Anëtarët e kuvendit të komunës; Sekretaria e Kuvendit; Zyra për informim.	Ueb-faqja e komunës;	Udhëzim Administrativ (MAP) Nr. 01/2015 për ueb faqet e institucioneve publike; Rregullorja komunale për përdorimin e gjuhëve.	

	Publikimi i të dhënave për përbërjen e komiteteve të kuvendit dhe funksioneve të tyre	1) Të dhënat e përfaqësuesve në komitete të publikuara; 2) vendimet për themelimin e komiteteve të publikuara; 3) Përgjegjësitë e komiteteve të përshkruara në ueb-faqe.	Sipas kohës së themelimit dhe funksionalizimit ;	Kryesuesi i kuvendit të komunës; Kryesuesi i komitetit përkatës; Sekretaria e Kuvendit; Zyra për informim.	Ueb-faqja e komunës	Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna; Udhëzim Administrativ (MAP) Nr. 01/2015 për ueb faqet e institucioneve publike.	
	Themelimi i komiteteve konsultative	Numri i komiteteve konsultative të themeluara; Numri i kërkesave të parashtruara për themelim të komiteteve.	Iniciativë e kuvendit të komunës apo pas parashtrimit të kërkesës / ose me rastin e përfundimit të mandatit të komitetit	Kuvendi i kuvendit të komunës		U.A. 01/2016 për procedurën e themelimit, organizimin dhe kompetencat e komiteteve konsultative në komuna	
Transparencia e Kryetarit të Komunës / Përfshirja e qytetarëve/ Qasja në dokumentet publike / Informimi publik							
Informimi i rregullt i qytetarëve dhe	Publikimi i akteve të kryetarit të komunës	Lista e akteve të aprovuara e publikuar	Në vazhdimësi	Zyra për informim; Zyra e Kryetarit	Ueb-faqja e komunës	Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;	

grupeve të interesit për aktivitetet dhe vendimet e kryetarit të komunës	Publikimi listës së pronave të planifikuara për dhënie në shfrytëzim për vitin e ardhshëm, pas miratimit në Kuvend të Komunës	Lista e pronave e planifikuar për dhënie në shfrytëzim, e publikuar	Deri me 31 dhjetor të vitit paraprak	Zyra e Kryetarit; Sekretaria e kuvendit; Zyra për informim.	Ueb-faqja e komunës; Gazeta Zyrtare e Kosovës	Ligji Nr.06/L- 092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;	
	Mbajtja e se paku dy takimeve publike me qytetarë brenda vitit	2 takime të mbajtura gjatë vitit	Takimi i parë në gjashhtëmujorin e parë të vitit; Takimi i dytë në gjashhtëmujorin e dytë të vitit	Zyra e Kryetarit; Zyra për informim.	Njoftimi përmes ueb- faqes së komunës; Shfrytëzimi i platformave online të komunikimit; Takime të drejtpërdrejta;	Ligji Nr. 03/L- 040 për Vetëqeverisje Lokale; Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;	

Numri i takimeve konsultative tjera në kuadër të lagjeve, vendbanimeve dhe lokacioneve tjera.	Numri i takimeve për të cilat është plotësuar kushti i njoftimit 14 ditë dhe gjuhët zyrtare;	Numri i takimeve për të cilat kërkesat dhe rekomandimet e dhëna nga publiku janë evidentuar dhe publikuar në ueb faqen zyrtare të komunës, brenda 15 ditëve pas përfundimit të takimit.	Njoftimi i shpallur 14 ditë para takimit në gjuhët zyrtare	Zyra e Kryetarit; Zyra për informim.	Njoftimi përmes ueb-faqes së komunës; Shfrytëzimi i platformave online të komunikimit; Takime të drejtpërdrejta;	Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;	
Shqyrtimi i kërkesave/iniciativave dhe peticioneve të qytetarëve	1) Numri i kërkesave, iniciativave qytetare dhe peticioneve të parashtruara tek Kryetari; 2) Numri i iniciativave kërkesave, iniciativave qytetare dhe	Në vazhdimësi	Kuvendi i komunës; Kryetari i komunës.			Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;	

Përfshirja e hershme e publikut në procesin e planifikimit të punëve të kryetarit të komunës	Draft-Plani i ekzekutivit për vitin e ardhshëm kalendarak i publikuar për konsultim me qytetarë	Deri në fund të muajit dhjetor	Zyra për informim; Zyra e Kryetarit;	Ueb-faqja e komunës; Platforma Qeveritare për Konsultime Publike; Forma të tjera të vlerësuar nga komuna	Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna; Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna				
Përfshirja e hershme e publikut në procesin e planifikimit të punëve të kuvendit të komunës	Draft-Plani i kuvendit të komunës për vitin e ardhshëm kalendarak i publikuar për konsultim me qytetarë	Deri në fund të muajit dhjetor	Kryesuesi i Kuvendit të komunës; Sekretaria e kuvendit; Zyra për informim.	Ueb-faqja e komunës; Platforma Qeveritare për Konsultime Publike; Forma të tjera të vlerësuar nga komuna	Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna; Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të				

							Konsultimet Publik në Komuna	
Mbajtja e konsultimeve me qytetarë për projektbuxhetin e komunës nga ekzekutivi i komunës	Konsultimet publike për projektbuxhet, të mbajtura nga kryetari i komunës / ekzekutivi	Para datës 1 shtator	Kryetari i komunës; Drejtorja për Ekonomi dhe Financa; Drejtoritë tjera.	Njoftimi përmes ueb-faqes së komunës, apo shpalljeve të tjera; Takime të drejtpërdrejta; Konsultimet me shkrim; Konsultimet elektronike; Publikimi në Platformën qeveritare për konsultime publike; Format tjera të përcaktuara në nenin 10 të U.A. për standardet minimale të konsultimit publik.	Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna; Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;			

Mbajtja e konsultimeve me qytetare për projektbuxhetin e komunës nga Kuvendi i Komunës	Konsultimet publike për projektbuxhet, të mbajtura nga Kuvendi i Komunës	Para datës 30 shtator	Kryesuesi i kuvendit të komunës; Sekretaria e Kuvendit; Drejtorja për Ekonomi dhe Financa;	Njoftimi përmes ueb-faqes së komunës, apo shpalljeve të tjera; Takime të drejtpërdrejta; Konsultimet me shkrim;	Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna; Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;	
Mbajtja e konsultimeve me qytetare për Planin Zhvillimor Komunal, Harta Zonale dhe Planet Rregullative	PZHK, HZ dhe Planet Rregullative të konsultuara me publikun	Në vazhdimësi	Zyra e Kryetarit; Kryesuesi i grupit punues për hartimin e	Publikimi i procesverbaleve dhe raporteve në Ueb-faqja e komunës Format tjera të përcaktuara në nenin 10 të U.A. për standardet minimale të konsultimit publik.	Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit	

					draft dokumentit; Drejtoria e Planifikimit; Zyra për informim;		Publik në Komuna;	
Rritja e transparencës dhe llogaridhënies së kryetarit/ekzekutivit	Diskutimi i raportit të kryetarit në kuvendin e komunës	Raportet e paraqitura për diskutim në kuvendin e komunës	Njëherë në gjatë të muaj apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i komunës	Kryetari i komunës; Ekzekutivi;	Inkorporimi në rend dite; Diskutimi në kuvend	Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale;		
	Dorëzimi i raporteve tremujore financiare në kuvendin e komunës dhe publikimi në ueb-faqen zyrtare	1) Raportet e paraqitura për diskutim në kuvendin e komunës; 2) Raportet e publikuara në ueb-faqe	1) Tremujori 4 para datës 31 Janar; 2) Tremujori 1 para datës 30 Prill; 3) Tremujori 2 para datës 31 Korrik; 4) Tremujori 3 para datës 31 Tetor	Kryetari i komunës; Ekzekutivi; Zyra për informim.	Inkorporimi në rend dite; Diskutimi në kuvend; Publikimi në ueb-faqe.	Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;		

Publikimi i raportit përfundimtar financiar	Raporti i publikuar	Jo më vonë se me 31 Mars të çdo viti kalendarik	Kryetari i komunës; Ekzekutivi; Zyra për informim.	Ueb-faqja zyrtare e komunës	Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë; Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;	
Publikimi i listës së subjekteve përfituese nga kategoria e subvencioneve	Lista e përfituesve të subvencioneve, e publikuar;	Pas miratimit të listës nga ana komisionit vlerësues	Zyra e informimit Drejtoria përkatëse.	Ueb-faqja zyrtare e komunës; platformat e tjera sociale	Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;	
Prezantimi, diskutimi në kuvendin e komunës si dhe publikimi i Raportit të Performancës Komunale	Raporti i Performancës Komunale i prezantuar dhe i diskutuar në kuvendin e komunës Raporti i Performancës Komunale i publikuar në ueb faqen e komunës	Qershor	Kryesuesi i kuvendit të komunës; Sekretaria e Kuvendit; Zyra për informim.	Ueb-faqja e komunës;	Rregullore Nr.01/2020 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Skemën e Grantit të Performancës Komunale	

	Diskutimi i raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit në Kuvendin e Komunës	Raporti i inkuorporuar në rend të ditës dhe i diskutuar në KK; Raporti i publikuar në uebfaqen e komunës	Pas publikimit nga ZKA	Kryesuesi i kuvendit; Kryetari i komunës; Zyra për informim.	Inkuorporimi në rend dite; Diskutimi në kuvend; Publikimi në ueb-faqe	Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;	
	Publikimi i Planit të Prokurimit për vitin fiskal	Plani i prokurimit i publikuar në ueb-faqe	Pas miratimit dhe shpalljes së ligjit vjetor për buxhetore	Zyra për prokurim; Zyra e informimit	Ueb-faqja e komunës; E-prokurimi	Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;	
Sigurimi i transparencës në procedurat e prokurimit publik	Publikimi i Raportit vjetor të zbatimit të Planit për prokurim publik	Raporti i prokurimit i publikuar	Jo me vone se 31 janar, për vitin paraprak	Zyra për prokurim; Zyra e informimit	Ueb-faqja e komunës	Ligji i Prokurimit Publik; Udhëzimet Administrativ të MAP-it për mirëmbajtjen e faqeve elektronike të institucioneve publike; Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik; Udhëzimi Administrativ (MPL)	

							Nr.03/2020 për Transparencë	
	Publikimi i gjitha aktiviteteve të prokurimit në ueb- faqen e komunës	Numri i aktiviteteve të prokurimit të publikuara në	Në vazhdimësi	Zyra për prokurim; Zyra e informimit.	Ueb-faqja e komunës; E- prokurimi	Ligji i Prokurimit Publik; Udhëzimet Administrativ të MAP-it për mirëmbajtjen e faqeve elektronike të institucioneve publike; Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik; Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë		
	Krijimi i strukturave përgjegjëse komunale për koordinimin dhe zbatimin e standardeve minimale të konsultimit publik	Zyrtari përgjegjës për konsultim publik, i caktuar me vendim të kryetarit		Kryetari i komunës;		Udhëzimet Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në		

Ngritja e cilësisë së konsultimeve të politikave dhe akteve të komunës përmes zbatimit të standardeve minimale të konsultimit publik në nivel lokal	Përgatitja e planit të veçantë për të gjitha propozimet e akteve nënligjore dhe politikave lokale, të cilat i nënshtrohen procesit të konsultimit publik gjatë vitit	Plani i veçantë i hartuar	Muaji dhjetor për vitin vijues	Zyrtari përgjegjës për konsultim publik; Njësitë organizative të komunës	Inkorporimi i aktiviteteve të planit vjetor të punës së komunës në planin e veçantë për konsultime	Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna;	
	Informimi me kohë për dokumentet, projekt-aktet, mënyrat dhe format e konsultimit, vendin dhe afatet e konsultimit publik	1. Numri i akteve/dokumenteve për të cilat kërkohet konsultimi publik; 2) Numri i njoftimeve të shpallura për konsultime publike; 3) Bashkëngjitja projekt-propozimit, dokumentin konsultues që përmban afatet e konsultimit, memorandumet shpjeguese dhe adresën për pranimin e	Të paku tetë (8) ditë dhe maksimum katërbëdhjetë (14)	Zyrtari përgjegjës për konsultim në koordinim me zyrtarin përgjegjës për hartim të projekt-propozimit	Ueb-faqja e komunës; Rrjetet sociale; Media lokale etj.	Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna;	

			përfundimit të afatit për paraqitjen e propozimeve dhe vërejtjeve me shkrim	për konsultime publike	Publikimi i dokumentacionit për konsultim në ueb-faqen e komunës dhe platformën qeveritare të konsultimeve publike.		
Garantimi i plotë i të drejtave për qasje në dokumentet publike	Shqyrtimi i rregullt i kërkesave për qasje në dokumente publike	1) Numri i kërkesave të parashtruara nga palët; 2) Numri i kërkesave të shqyrtuara për të cilat palët kanë marrë përgjigje	(7) ditë nga dita e pranimit të kërkesës nga kërkuesi	Zyra për informim / Zyrtari përgjegjës për qasje në dokumentet zyrtare; Qendra për Shërbim të qytetarëve Njësia përgjegjëse për ofrimin e qasjes	Pranimi përmes zyrtarit përgjegjës për konsultime publike. Shqyrtimi nga organi kompetent;	Ligji Nr.06/L-081 për qasje në dokumente publike	

	Mbajtja e evidencës zyrtare, në formë të regjistrit ose ngjashëm, përkritazi me kërkesat, veprimet, procedurat dhe vendimet, lidhur me realizimin e të drejtave të personave fizik dhe juridik, në qasje në dokumente dhe informata zyrtare.	Regjistri me të dhënat zyrtare, i përditësuar dhe publikuar;	Përditësohet çdo tre (3) muaj	Zyra për informim/ Zyrtari përgjegjës për qasje në dokumentet zyrtare/	Ueb-faqja e komunës	Ligji Nr.06/L-081 për qasje në dokumente publike
	Hartimi dhe publikimi i raportit për qasje në dokumentet publike	1) Raporti vjetor i hartuar dhe dorëzuar në Agjencinë për informim dhe privatësi; 2) Raporti i publikuar në ueb-faqe	Jo më vonë se 31 janar	Zyrtari përgjegjës për qasje në dokumentet zyrtare	Ueb-faqja e komunës	Ligji Nr.06/L-081 për qasje në dokumente publike

	Publikimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB)	KAB i publikuar në ueb-faqen e komunës	Pas miratimit në Kuvendin Komunal	Kryesuesi i Kuvendit të Komunës; Sekretaria e Kuvendit; Zyra e Kryetarit; Zyra për informim.	Ueb-faqja e komunës	Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna	
	Publikimi i buxhetit vjetor	Plani buxhetor i publikuar në ueb-faqen e komunës	Pas miratimit në kuvendin e komunës	Zyra për informim; Zyra e Kryetarit	Ueb-faqja e komunës	Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;	
	Publikimi i procesverbaleve nga mbledhjet e takimeve të kuvendit të komunës dhe Komiteteve obligative	Procesverbalet e mbledhjeve të kuvendit të komunës të publikuara në ueb-faqen e komunës Procesverbalet e mbledhjeve të komiteteve obligative të publikuara në ueb-faqen e komunës	Pas miratimit në kuvendin e komunës Pas miratimit në mbledhjet pasuese të komiteteve obligative	Kryesuesi i kuvendit; Kryesuesi i komitetit obligativ; Sekretaria e kuvendit; Zyra për informim;		Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;	

	Publikimi i Strategjive dhe dokumentet tjera të politikave në nivel lokal	Strategjitë dhe dokumentet tjera të politikave në nivel lokal të miratuara publikohen në ueb faqe	Pas miratimit në kuvendin e komunës	Kryesuesi i kuvendit; Sekretaria e kuvendit; Drejtorja përkatëse; Zyra për informim;	Ueb-faqja e komunës;	Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;
	Publikimi i Planit Zhvillimor Komunal, Hartat Zonale dhe Planet Rregulluese	PZHK, HZ dhe PR të publikuara në ueb faqen e komunës	Pas miratimit në kuvendin e komunës	Kryesuesi i kuvendit; Sekretaria e kuvendit; Drejtorja përkatëse; Zyra për informim;	Ueb-faqja e komunës;	Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;
Përmeshja e kritereve të ueb-faqes zyrtare, lehtësimi i marrjes së shërbimeve dhe informimi i rregullt për qytetarë	Publikimi i procedurave në marrjen e shërbimeve të ofruara nga drejtoritë dhe njësitë organizative të komunës	1) Numri i shërbimeve që ofron institucioni për publikun; 2) Numri i procedurave dhe kushteve të përfitimit të tyre dhe afati i detyrueshëm për të marrë përgjigje	Në vazhdimësi	Drejtorja e Administratës Zyra për informim	Ueb-faqja e komunës; Qendra për shërbim të qytetarëve	Udhëzim Administrativ (MAP) Nr. 01/2015 për ueb faqet e institucioneve publike; Udhëzimi Administrativ (MAPL)

		për shërbimin e kërkuar të publikuara në gjuhët zyrtare; 3) Lista e hollësishme e shërbimeve që ofron institucioni për publikun, si: licenca, leje, autorizime, certifikata, vërtetime apo shërbime publike të tjera, ku do të përfshihen, e publikuar në gjuhët zyrtare.	Në vazhdimësi	Drejtori i Administratës/ Qendra për Shërbim të Qytetarëve	Qendra për Shërbim të Qytetarëve	Nr.03/2020 për Transparencë;	
	Ofrimi i shërbimeve elektronike nga Qendra për Shërbim të Qytetarëve	Informimi dhe ofrimi i shërbimeve të hapura online nga Qendra për Shërbim të Qytetarëve. Ofrimi i shërbimeve për qytetarët përmes E-kioskës.				Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.03/2020 për Transparencë; Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 01/2021 për funksionimin e Qendrave të Shërbimeve të Qytetarëve në komunë	